



LIVE HEALTHY, STAY ACTIVE

ACTIVE LIFE

SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME “SAID NAJDENI”

PESHKOPI, DIBËR



Përmbajtja

- Faqja e Titullit
- Përmbajtja e Raportit
- Përshkrimi i Kompanisë
- Vizioni & Misioni
- Struktura e Departamenteve/Ekipi
- Problemi, Zgjidhja, Klienti
- Produkti
- Marketing & Shitje
- Pasqyra Financiare
- Përmbledhje

Instagrami ynë:

https://www.instagram.com/activelife.today?igsh=ZDVpcmgxaTBveDQ2&utm_source=qr



Përshkrimi i Kompanisë ●●●●●

ActiveLife është një nismë inovative që synon të transformojë mënyrën se si të rinjtë e shohin aktivitetin fizik, duke e kthyer atë në një element argëtues dhe të thjeshtë të jetës së përditshme.

ActiveLife ekziston për t'i dhënë zgjidhje një problemi real: mungesës së motivimit dhe strukturës tek të rinjtë për të ndjekur një stil jetese aktiv. Në një kohë ku shumë të rinj duan të merren me sport, por nuk dinë nga t'ia fillojnë ose e braktisin shpejt, ActiveLife synon ta bëjë këtë proces më të thjeshtë, më të aksesueshëm dhe më tërheqës.

Çdo ditë, kompania fokusohet në zhvillimin e përmbajtjeve dhe mjeteve që ndihmojnë përdoruesit të jenë më aktivë, duke ofruar programe stërvitjeje, plane ushqimore dhe eksperiencë interaktive përmes platformës digjitale. ActiveLife i drejtohet kryesisht të rinjve, duke u përshtatur me nevojat dhe stilin e jetesës së tyre.

Në të ardhmen, ActiveLife synon të zgjerohet dhe të kthehet në një platformë të njohur jo vetëm në tregun vendas, por edhe më gjerë, duke ndërtuar një komunitet aktiv dhe të angazhuar përdoruesish.

Ëndrra e kompanisë është të bëhet një markë që ndryshon mënyrën se si të rinjtë e shohin aktivitetin fizik — jo si një detyrim, por si një pjesë të natyrshme dhe të këndshme të jetës së përditshme. Pas disa vitesh, ActiveLife e sheh veten si një platformë të zhvilluar, me mijëra përdorues aktivë dhe me një ndikim real në përmirësimin e stilit të jetesës së të rinjve.


●●●●●

VIZIONI DHE MISIONI



VIZIONI

Të bëhemi platforma numër një në rajon për motivimin e të rinjve drejt një jete aktive, duke krijuar një kulturë ku sporti shihet si argëtim dhe jo si detyrim.




MISIONI

Të ofrojmë udhëzime të personalizuara në gjuhën shqipe dhe produkte interaktive që thyejnë monotoninë e stërvitjes tradicionale.

Struktura e Kompanisë / Ekipi

Organizimi ynë mbështetet në një hierarki të qartë ku secili departament drejtohet nga një përgjegjës specifik për të siguruar mbarëvajtjen e operacioneve të ActiveLife:

- **Presidentja: Xhena Ceka** – Udhëheq vizionin e përgjithshëm dhe koordinon bashkëpunimin mes të gjithë drejtorëve.
- **Drejtoresha e Marketingut: Ina Kaba** – Përgjegjëse për fushatat në rrjetet sociale, partneritetet me influencerët dhe imazhin e markës.
- **Drejtoresha e Financës: Klea Selami** – Menaxhon buxhetin, kostot e prodhimit dhe monitoron fitimin neto të kompanisë.
- **Drejtoresha e Prodhimit: Ajselda Përgjegji** – Mbikëqyr krijimin e paketave fizike (Kartelat & Journal) dhe zhvillimin e ekosistemit digjital.
- **Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun: Emiljano Lusha** – Menaxhon komunikimin me jashtë, eventet promovuese dhe kontaktet me klientët e parë.




Problemi, Zgjidhja, Klienti



PROBLEMI

Pasiviteti fizik te të rinjtë shqiptarë për shkak të mungesës së mjeteve në gjuhën shqipe, kostove të larta të palestrave dhe perceptimit të ushtrimeve si proces i mërzitshëm.



ZGJIDHJA

Një model Freemium (akses fillestar falas) që bashkon "Challenge Cards" me një App që ofron plane ushqimore dhe stërvitjeje të personalizuar.



KLIENTI

Të rinjtë e moshës 13–25 vjeç, nxënës dhe studentë, të cilët kërkojnë zgjidhje praktike, digjitale dhe ekonomike.



Produkti/Shërbimi



ActiveLife Web/App:

Platformë që shërben si trajner personal digjital me udhëzues në shqip.

Fitness Journal

Një ditar fizik i krijuar për monitorimin e përditshëm të progresit, i cili ndihmon përdoruesit të ndërtojnë disiplinë dhe të dokumentojnë arritjet e tyre në mënyrë të prekshme.

Sistemi i Personalizuar:

Përfshirja e një pyetësi inteligjent brenda platformës që orienton çdo përdorues drejt aktiviteteve dhe sfidave më të përshtatshme bazuar në nivelin e tyre fizik.



ActiveLife Challenge Cards:

Një set prej 40 kartelash sfidash që e transformojnë aktivitetin fizik në lojë dinamike, të cilat mund të përdoren kudo (në shtëpi, park ose shkollë) pa pasur nevojë për pajisje të shtrenjta.



Marketing dhe Shitje



Kosto për njësi (paketë produkti)

- Produkti përfshin një kombinim të përmbajtjes digjitale dhe fizike që ndihmon përdoruesin të ndjekë një stil jetese aktiv në mënyrë të strukturuar dhe të thjeshtë.

Kosto për njësi:

- Journal: 450 – 750 lekë
- Paketim + transport: 200 – 400 lekë
- Web/App: falas (me opsione abonimi: Premium 10€, Ultra 20€)

Totali: ~650 – 1,150 lekë / njësi (+ të ardhura shtesë nga abonimet)**

Çfarë mund të realizojmë vetë

- Dizajnin e platformës (web/app) dhe përmbajtjes
- Krijimin e programeve të stërvitjes dhe planeve ushqimore
- Dizajnin e journal-it dhe materialeve të tjera
- Menaxhimin e rrjeteve sociale dhe marketingut bazë


Për çfarë kemi nevoj

- Hosting dhe domain për publikimin e web/app
- Printim për produktet fizike (journal)
- Materiale për paketim
- Reklama dhe promovim online



Pasqyra Financiare


- **Të Ardhurat Totale:** 37,000 lekë (nga shitjet fizike dhe abonimet).
- **Shpenzimet Totale:** 53,000 lekë (prodhimi, marketing dhe kosto operative).
- **Fitimi Neto:** 140,000 lekë.
- **Investimi Fillestar:** 30,000 lekë.



Përmbledhje



ActiveLife nuk është thjesht një produkt, por një lëvizje drejt shëndetit. Me një fitim neto të parashikuar prej 140,000 lekësh në fazën fillestare dhe një plan të qartë për zgjerimin e komunitetit në 5,000+ ndjekës, kompania është e gatshme të sfidojë pasivitetin fizik dhe të krijojë një standard të ri në industrinë e fitnesit në Shqipëri.



Letra e presidentit

Të nderuar aksionerë,

ActiveLife nuk ka lindur si një ide e madhe biznesi në letër, por si një vëzhgim i thjeshtë i një realiteti që e shohim çdo ditë: shumë të rinj duan të jenë aktivë dhe të kujdesen për veten, por shpesh nuk e dinë nga t'ia fillojnë ose e humbin motivimin rrugës.

Ky projekt është përpjekja jonë për ta bërë këtë më të lehtë. Jo duke e komplikuar, por duke e thjeshtuar duke krijuar një platformë dhe produkte që i udhëheqin të rinjtë hap pas hapi, në mënyrë më të kuptueshme dhe më të afërt me jetën e tyre të përditshme.

Gjatë këtij procesi kemi mësuar, kemi ndërtuar dhe kemi besuar se edhe një ide e thjeshtë mund të ketë ndikim real nëse fokusohet te nevojat e njerëzve.

Për ne, ActiveLife nuk është vetëm një projekt, por një mënyrë për të ndihmuar të rinjtë të ndihen më mirë me veten e tyre dhe të krijojnë zakone më të shëndetshme, pa presion dhe pa e bërë këtë një barrë.

Ju falënderoj për besimin dhe për mbështetjen në këtë rrugëtim që sapo ka filluar.

Me respekt, Xhena Ceka Presidente



Letra për Vullnetarin

E nderuar,

Në emër të ekipit të ActiveLife, dëshirojmë të të shprehim një falënderim të singertë për kohën, energjinë dhe mbështetjen që ke dhënë në këtë projekt.

Kontributi yt ka qenë i rëndësishëm për realizimin dhe përmirësimin e idesë sonë, duke ndihmuar që ActiveLife të marrë formë dhe të afrohet më shumë me qëllimin e tij: të ndihmojë të rinjtë të jenë më aktivë dhe më të motivuar.

Vullnetarizmi yt tregon përkushtim dhe gatishmëri për të qenë pjesë e një iniciative që synon të sjellë ndryshim pozitiv, dhe kjo vlerësohet shumë nga ne.

Faleminderit që u bërë pjesë e këtij rrugëtimi.

Me mirënjohje, Ekipi ActiveLife



Statuti i Shoqërisë

Neni 1 – Emri dhe Forma

Shoqëria vepron nën emrin “ActiveLife” dhe është një iniciativë që ofron produkte dhe shërbime në fushën e aktivitetit fizik, mirëqenies dhe stilit të shëndetshëm të jetesës.

Neni 2 – Qëllimi i Shoqërisë

Qëllimi i shoqërisë është të ndihmojë të rinjtë të adoptojnë një stil jetese më aktiv dhe më të shëndetshëm përmes një platforme digjitale dhe produkteve fizike që e bëjnë procesin më të thjeshtë dhe motivues.

Neni 3 – Veprimtaritë Kryesore

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformës web/app
- Ofrimi i programeve të stërvitjes dhe planeve ushqimore

- Krijimi dhe shitja e produkteve fizike (journal etj.)

- Aktivitete marketingu dhe promovimi

Neni 4 – Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga themeluesja dhe ekipi i saj, të cilët janë përgjegjës për vendimmarrjen strategjike dhe zhvillimin e projektit.

Neni 5 – Të Ardhurat

Të ardhurat gjenerohen nga shitja e produkteve fizike dhe abonimet në platformën digjitale (Premium dhe Ultra). Këto të ardhura përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të shoqërisë.